



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 12.07.2018*

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

“RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHITESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 12.07.2018 shqyrtoi projektligjin” *Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale*” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, znj. Bardhylka Kospiri, zëvendesministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Denada Seferi, Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Erion Luci, Zëvendësministër në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, znj. Luljeta Dauti, Specialiste në MFE, z. Tedi Bushaj – Specialist në MFE, znj. Brikena Jazxhi – Specialist në MFE

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

. Njëpërmjet këtij projektligji mundësohet shtimi i vlerës së huas në shumën 11 milionë USD. Pala Shqiptare ka kërkuar pranë BERZH një financim tjetër shtesë në mbështetje të aktiviteteve të reja, të cilat detajohen në Skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe konsistojnë kryesisht në sa më poshtë vijon:

Pjesa 1: Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale, përmes mbështetjes e zbatimit të përmirësuar, si e programit të ndihmës ekonomike (PNE), ashtu edhe e programit të aftësisë së kufizuar (PAK).

Pjesa 2: Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e asistencës sociale përmes mbështetjes për zbatimin e përmirësimeve në dhënien e pagesave të asistencës sociale, përmes sa më poshtë:

- a) Rishikimit të parametrave të programeve të asistencës sociale.
- b) Përgatitjes së një strategjie daljeje për përfituesit e PNE-së bazuar në modele novatore dhe në përvojën ndërkombëtare.
- c) Vënien në zbatim e një sistemi për menaxhimin e informacionit (SMI) për PAK, duke përfshirë shqyrtimin e procedurave bazë të punës, roleve institucionale dhe kërkesave funksionale për të përcaktuar faktorët e përdorur në projektimin e sistemit për menaxhimin e informacionit; zhvillimin e kontrollit të cilësisë për përgatitjen dhe vënien në zbatim të sistemit për menaxhimin e informacionit; përgatitjen e një politike të rishikuar për sanksionet dhe të mekanizmave të zbatimit për të rritur mundësitë për zgjidhjen e rasteve të mashtrimeve dhe gabimeve; dhe hartimin e instrumenteve për zbulimin e mashtrimeve dhe gabimeve, dhe mekanizmave të tjerë të inspektimit social.
- d) Nxitjen e transparencës në komunikim dhe në monitorim-vlerësim, si edhe në angazhimin e qytetarëve etj.

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve të akorduara njëpërmjet kësaj marrëveshjeje huaje është data 30 qershor 2021.

Huaja e akorduar nëpërmjet kësaj marrëveshjeje është në shumën 11 000 000 USD dhe me afat maturimi 27 vjet, duke përfshirë periudhën prej 7 vitesh pa pagesë principali. Projekti do të jetë pjesë e parashikimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

5.0 Diskutimet në Komision :

Deputetet në diskutimet e tyre vlerësuan rëndësinë e projektligjit dhe bënë pyetje për të marrë një informacion më të zgjeruar si faktin se si do të behej i zbatueshëm projekti. Në përgjigjet e dhëna nga drejtuesit e institucioneve pyetjeve të tyre, u sqaruar rreth detajeve të tjera të marrëveshjes.

6.0 Aspekti procedural i projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për ratifikim në zbatim të nenit 81, pika 1 dhe 121 pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

Kjo marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, Kreu II”Marrëveshjet Ndërkombëtare, në neni 121 i saj. Marrëveshja është hartuar, mbështetur në pikën 2, të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” në të cilën thuhet “

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.
2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:
 - a) projektligji për ratifikim;
 - b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;
 - c) vendimi i miratimit në parim;
 - ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;
 - d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;
 - dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.
3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit “

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit të marrëveshjes “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale” është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI